



Një ëndërr **bëhet realitet**

**Origjinali: VW Bus – ose i quajtura me dashuri "Bulli"– ka qenë shoqëruesi ideal për kërkesat më të larmishme për jetën e përditshme profesionale dhe private për mbi 65 vite.**

Përjetoni historinë magjepsëse të Bullit, filluar nga viti 1950, viti kur lindi T1, deri tek modeli aktual T6.1. Si transportues, kamionçinë, autobus për transport personash, si mjet pushimesh, apo si kamper: Me kategorinë e automjeteve të sapo krijuar "Klasa autobus", Volkswagen ia arriti të sjellë në treg një automjet që ofron një rang të gjerë variantesh të dobishme. Bulli ishte jo vetëm bindës si "Vend pune" i lëvizshëm, por edhe si shtëpi e lëvizshme përrreth globit.

Automjeti kult udhëtoi në zemrat e pronarëve të tij për breza me radhë. Për shumë persona një ëndërr e realizuar kur mund të niseshin për aventura të reja me Bullin e tyre si një shtrat me rrota. Teksa udhëton

me Bullin, rruga shndërrohet në destinacion që ofron kënaqësi të plotë. Në çdo kilometër të përshkuar, ai shkruan histori, pasuron me kujtime dhe fiton vlera ideale për çdo drejtues të Bullit. Si shok besnik, Bulli është gjithmonë i ngulitur thellë në jetën e njerëzve. Të pasionuarit e Bullit mblidhen për të formuar komunitete tifozësh dhe ndajnë entuziazmin e tyre për automjetin e gjithanshëm gjatë ngjarjeve dhe takimeve të ndryshme. Edhe pse Bulli mbetet në llojin e vet me kalimin e viteve, automjeti dhe kërkesat e tij vazhdojnë të zhvillohen.

Në këtë drejtim, do të vazhdojë të shkruajë historinë e automjeteve në të ardhmen.